


Kë zgjedh Mali i Zi?

- gjinia, mosha, struktura gjeografike dhe
profesionale e listave zgjedhore në zgjedhjet
e jashtëzakonshme parlamentare të vitit 2023 -



Kë zgjedh Mali i Zi?

-gjinia, mosha, struktura gjeografike dhe profesionale e listave zgjedhore në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të vitit 2023 -

Botuesi:

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)

Redaktore:

Daliborka Ulareviq

Autorja:

Millijana Raduloviq

Bashkëpunëtor:

Damir Suleviq

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Monika Mrnjaçeviç

Dizajni dhe produksioni:

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)



Publikimi “KË ZGJEDHË MALI I ZI? - gjinia, mosha, struktura gjeografike dhe profesionale e listave zgjedhore në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të vitit 2023”, është përgatitur me mbështetjen e Core grant të projektit rajonal SMART Balkans- Shoqëria civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor, zbatuar nga Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile (QPSC), Qendra për Kërkime dhe Politika Publike (QKPP) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) dhe mbështetet financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë.

Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e Qendrës për Arsimim Qytetar (QAQ) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e QPSC, QKPP, IDN dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë.

Kë zgjedh Mali i Zi?

-gjinia, mosha, struktura gjeografike dhe profesionale e listave
zgjedhore në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të vitit 2023 -

Podgoricë, 2023.

Përmbajtja

Hyrje_____	5	7. Kthesa për Malin e Zi të sigurt- Srgjan Periq_____	19
Analiza e përgjithshme e listave zgjedhore_____	6	8. Lëvizja për Ndryshime- SË PARI MALI I ZI – Nebojsa Medojeviq – Reformat për shpëtimin e vendit_____	20
Zbërthim i detajuar sipas listave zgjedhore _____	12	9. PO. NE MUNDEMI PËR MALIN E ZI QYTETAR!_____	21
1. Është e qartë! – Partia Boshnjake - mr Ervin Ibrahimoviq_____	13	10. BASHKË! Për të ardhmen që të takon - Danijel Zhivkoviq (PDS, SD, UDSH, PL) ____	22
2. IQK- Në anën e drejtë të botës____	14	11. EVROPA TANI – MILOJKO SPAJIQ ____	23
3. DREJTËSI PËR TË GJITHË! – dr VLADIMIR LEPOSAVIQ_____	15	12. PSD – PËR SHTËPINË TONË_____	24
4. PPS - DEMOS – PËR TY. _____	16	13. ALEKSA DHE DRITANI – GUXIMI vlerësohet!_____	25
5. KOALICIONI POPULLOR – TË BASHKUAR DHE PIKË. (Dejan Vukshiq - Lëvizja Demokristiane; Marko Millaçiq - Mali i Zi i Vërtetë; Vlladisllav Dajkoviq - Mali i Zi i Lirë; Dragica Peroviq - Partia Demokratike Serbe; dr Novica Staniq - Lëvizja për Plevlën) _____	17	14. PËR TË ARDHMEN E MALIT TË ZI (Demokracia e Re Serbe, Partia Popullore e Mali të Zi, Partia e Punës)____	26
6. ALEANCA SHQIPTARE _____	18	15. Forumi shqiptar – Nik Gjeloshaj "BESA për Zhvillim Evropian" _____	27

Hyrje

Zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare do të mbahen më 11 qershor 2023. Në zgjedhjet parlamentare do të marrin pjesë 15 lista zgjedhore, me gjithsej 1113 kandidatë/te¹ që do të garojnë për 81 poste parlamentare.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të ofrojë një prerje tërthore të atyre listave zgjedhore për sa i përket gjinisë, moshës, strukturës rajonale dhe profesionale të kandidatëve/eve, në mënyrë që qytetarët, si dhe publiku i interesuar, të kenë një prerje më të thellë të ofertës zgjedhore në këtë aspekt.

Të dhënat janë përpunuar në mënyrë që të mos zbulojnë të dhëna personale të kandidatëve/eve për deputetë/e dhe të ofrojnë të gjitha informacionet përkatëse të përcaktuara nga detyra kërkimore.


¹ Lista përmbledhëse zgjedhore për zgjedhjet e deputetëve të Kuvendit të Malit të Zi në zgjedhjet që do të mbahen më 11 qershor 2023 - <https://dik.co.me/wp-content/uploads/2023/05/Zbirna-izborna-lista.pdf>

Analiza e përgjithshme e listave zgjedhore

Struktura gjinore

Sa i përket strukturës gjinore, të gjitha listat kanë plotësuar normën ligjore të të paktën 30% të kandidatëve/eve të gjinisë së nënpërfaqësuar dhe pozicionimin e të paktën një kandidati/e të gjinisë së nënpërfaqësuar në çdo të katërtin kandidatë/e², duke theksuar se pa këtë nuk do të të jetë në finale e as të konfirmuar nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ).

Nga gjithsej 1113 kandidatë/e, në lista janë 715 (64%) meshkuj dhe 398 (36%) gra. Këto të dhëna tregojnë pak progres në sigurimin e një ekuilibri më të madh gjinor, megjithëse ka ende hapësirë për përmirësim në arritjen e barazisë gjinore në rendet partiake, dhe rrjedhimisht pjesëmarrjen efektive politike të grave. Vetëm një nga 15 listat zgjedhore të konfirmuara drejtohet nga një grua. Është lista qytetare e PO. NE MUNDEMI PËR MALIN E ZI QYTETARI!, ku përqindja e përfaqësimit të grave është dukshëm mbi mesataren - 58%. Përveç kësaj liste, dy lista të partive të pakicave kombëtare - Partia Boshnjake (PB) dhe Inicijativë Qytetare Kroate (IQK) me 41% gra secila, si dhe koalicioni i mbledhur rreth Partisë Demokratike të Socialistëve (PDS) me 40% grave - janë dukshëm mbi mesataren, ndërsa në shumicën e të tjerave, përqindja e përfaqësimit të grave mbetet brenda kufijve të minimumit ligjor ose nën atë me të cilin theksohen listat e sipërpërmendura.



Grafiku: struktura gjinore

² Neni 39a i Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi", br. 4/98, 5/98, 17/98, 14/00, 18/00, 9/01, 41/02, 46/02, 45/04, 48/06, 56/06 i „Gazeta Zyrtare e Republikës së MZ”, broj 46/11,14/14, 47/14,12/16,60/17,10/18 i 109/20)


Struktura e moshës

Struktura moshore e kandidatëve/eve është shumë heterogjene, ku kandidati më i ri është 18 vjeç dhe më i moshuari 82³. Kur merren të 15 listat e konfirmuara, pra të gjithë 1113 kandidatë/e, moshë mesatare e atyre që duan të përfaqësojnë qytetarët në mbledhjen e ardhshme të Parlamentit është 41 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	< 20	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80	> 80
1113	4	221	388	228	157	88	25	2

Tabela: struktura e moshës

Lista më e re është DREJTËSI PËR TË GJITHË! – Dr. VLADIMIR LEPOSAVIQ me moshën mesatare të kandidatëve/eve 33 vjeç, ndërsa lista më e vjetër është IQK në të cilën kandidatët/et janë mesatarisht 51 vjeç.




Grafiku: struktura e moshës

3 Hulumtimi është kryer mes kandidatëve duke marrë parasysh strukturën e moshës në ditën e zgjedhjeve, 11 qershor 2023.

Struktura rajonale

Duke analizuar vendbanimin e përhershëm e kandidatëve/eve, vërehet një pabarazi e konsiderueshme në shpërndarjen e kandidatëve/eve nëpër komuna të ndryshme.

Përqendrimi më i madh i kandidatëve/eve është nga kryeqyteti i Podgoricës, 266, ose 23,9% e numrit të përgjithshëm. Pasohet nga Nikshiqi me 81 kandidatë (7.28%), Tuzi me 76 kandidatë (6.83%) dhe Ulqini me 72 kandidatë (6.47%). Në anën tjetër, komunat si Shavniku, Andrijeviça, Petnjica dhe Pluzhina kanë numrin më të vogël të kandidatëve - vetëm 5 ose 6 (0.45% - 0.54%).




Grafiku: struktura rajonale

Asnjë listë nuk përfshinte qytetarë dhe qytetare nga të gjitha 25 komunat në Mal të Zi. Më gjithëpërfshirësja në atë pjesë është lista e udhëhequr nga koalicioni i mbledhur rreth PDS-së, kandidatët/et e të cilit vijnë nga 24 komuna, më pas koalicioni i Demokratëve dhe URE-s me kandidatët/e që mbulojnë 23 komuna dhe koalicioni i Partisë Popullore Socialiste (PPS) dhe DEMOS-it që kanë kandidatët/e nga 21 komuna. Nga ana tjetër, janë tre lista të pakicave - Alternativa Shqiptare, kandidatët/et e së cilës vijnë nga tre komuna, lista IQK, e cila sipas strukturës së kandidatëve/eve përfshin pesë komuna dhe lista e Forumit Shqiptar, e cila ka kandidatë nga gjashtë komuna.

Struktura profesionale

Kandidatët/et karakterizohen gjithashtu nga një larmi profesionesh, gjë që mund të kontribuojnë në diversitetin e ideve dhe perspektivave që ata sjellin në arenën politike. Për qëllimet e këtij hulumtimi, profesionet janë grupuar në sektorët e mëposhtëm:

- 1. Drejtësia** (doktorë të shkencave juridike, juristë, specialistë të shkencave juridike, juristë të diplomuar, teknikë juridikë);
- 2. Shkencat politike dhe punë sociale** (doktorë të shkencave politike, magjistër të shkencave politike, të diplomuar për shkenca politike, të diplomuar për punonjës socialë);
- 3. Arsimi dhe shkenca** (doktorë shkencash, profesorë, mësues, historianë, biologë, matematikanë, kimistë, arkeologë, filozofë, filologë, mjekë ligjorë);
- 4. Shëndetësia** (mjekë, specialistë dhe subspecialistë, stomatologë, veterinerë, psikologë, pedagogë, kozmetologë, teknikë mjekësorë);
- 5. Ekonomi dhe menaxhim** (master i shkencave ekonomike, ekonomistë të diplomuar, auditorë, bankierë, kontabilistë, menaxherë të burimeve njerëzore, specialistë marketingu, menaxhim biznesi, teknikë ekonomie);
- 6. Teknologjia dhe inxhinieria** (inxhinierë të mekanikes, metalurgjisë, minierave, agronomisë, bujqësisë, pylltarisë, mbrojtjes së mjedisit, inxhinierë sanitarë, inxhinierë elektrikë, specialistë IT, programues, elektronikë, elektroteknikë, teknikë);
- 7. Inxhinieri dhe arkitekturë** (inxhinierë arkitekturë, inxhinierë ndërtimi, gjeodete, teknikë ndërtimi);
- 8. Turizmi, detaria dhe trafiku** (turizëmologë të diplomuar, përfaqësues të turizmit, punonjës turistikë, restauratorë, hotelierë, menaxherë detarë, detarë, kapiten, pilotë);
- 9. Arti, kultura, media dhe sporti** (artistë pamor, artistë vizualë, ekspertë të kulturës, konservatorë, regjisorë, regjisorë, video editorë, grafikë, gazetarë, sportistë).
- 10. Ekonomia** (sipërmarrës, biznesmenë, tregtarë, punëtorë në ekonomi, komercialistë, fermerë, artizanë)
- 11. Studentë dhe nxënës**
- 12. Pensionistët**
- 13. Të paklasifikuar** (agjentë sigurimesh, amvise, korrespondentë, korrespondentë të huaj, shoferë, kriminologë të diplomuar, oficerë, teknikë doganore, nëpunës civilë, administratë publike, ekspertë të diplomacisë amerikane, sekretarë biznesi, menaxherë sigurie).



Grafiku: struktura profesionale


Shumica e kandidatëve/eve janë nga fusha e ekonomisë dhe menaxhmentit (223), pasuar nga arsimi dhe shkenca (154) dhe drejtësia (149).

Për të thjeshtuar klasifikimin e profesioneve, rekomandohet përfshirja e udhëzimeve të detajuara në Udhëzim për përmbajtjen dhe formën e formularëve për emërimin e kandidatëve për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve. Për më tepër, Formulari PG-2 (Deklarata e Pranimi të Kandidaturës) mund të përmirësohet duke shtuar një fushë për të mbledhur të dhëna mbi nivelin e kualifikimit arsimor të kandidatit/es, e cila do të ofronte informacion më të detajuar rreth arsimimit dhe ekspertizës së tyre.

Zbërthim i detajuar sipas listave zgjedhore

1. Është e qartë! – Partia Boshnjake – mr Ervin Ibrahimoviq

Partia Boshnjake ka 48 meshkuj (59%) dhe 33 femra (41%) mes 81 kandidatëve/e.




Grafiku: struktura gjinore

Kur bëhet fjalë për strukturën e moshës, mesatarja është 37 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70
81	14	39	22	5	1

Tabela: raporti i strukturës së moshës


Numri më i madh i kandidatëve/eve është nga komuna e Rozhajës.



Grafiku: struktura rajonale

2. IQK – Në anën e drejtë të botës

IQK ka 71 kandidatë/e, mes tyre 42 meshkuj (59%) dhe 29 femra (41%).



Grafiku: struktura gjinore


Mesatarisht, kandidatët/et në këtë listë janë 51 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80	> 80
71	12	10	10	12	14	11	2

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Numri dominues i kandidatëve/eve janë nga Tivati.

■ Vendbanimi i përhershëm




Grafiku: struktura rajonale

Në strukturën profesionale, mbi një e katërta e kandidatëve/eve në këtë listë janë nga fusha e turizmit, detit dhe transportit.

3. DREJTËSI PËR TË GJITHË! – dr VLADIMIR LEPOSAVIQ

Kjo listë ka 55 kandidatë/e, nga të cilët 38 janë meshkuj (69%) dhe 17 janë femra (31%).



Grafiku: struktura gjinore


Moshë mesatare e kandidatëve në këtë listë është 33 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	< 20	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70
55	1	25	18	7	2	2

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Shumica e kandidatëve/eve në këtë listë janë nga Podgorica.

■ Vendbanimi i përhershëm




Grafiku: struktura rajonale

Kandidatët/et nga fusha e drejtësisë dhe studentët/et përfaqësohen me nga një të katërtën në këtë listë.

4. PPS - DEMOS - PËR TY.

Koalicioni PPS-DEMOS ka gjithsej 81 kandidatë/e, 55 meshkuj (68%) dhe 26 femra (32%).



Grafiku: struktura gjinore


Moshë mesatare e kandidatëve/eve në këtë listë është 41 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70
81	8	35	23	10	5

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Për sa i përket shpërndarjes gjeografike të kandidatëve/eve, lista është e shpërndarë, me një numër pak më të madh të atyre nga Podgorica.

■ Vendbanimi i përhershëm




Grafiku: struktura rajonale

Shumica e kandidatëve/eve, mbi një e pesta, në këtë listë vijnë nga sferat e ekonomisë dhe menaxhimit.

5. KOALICIONI POPULLOR – TË BASHKUAR DHE PIKË. (Dejan Vukshiq – Lëvizja Demokristiane; Marko Milaçiç – Mali i Zi i VËrtetë; Vladislav Dajkoviç – Mali i Zi i Lirë; Dragica Peroviç – Partia Demokratike Serbe; dr Novica Staniç – Lëvizja për Plevlën)

Ky koalicion ka gjithsej 81 kandidatë/e, prej të cilëve 56 meshkuj (69%) dhe 25 femra (31%).




Grafiku: struktura gjinore

Mosha mesatare e kandidatëve është 43 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80
81	14	27	15	12	8	5

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Shumica e kandidatëve/eve në këtë listë janë nga Podgorica.




Grafiku: struktura rajonale

Në listën e këtij koalicioni kryesojnë kandidatët/et nga fusha e ekonomisë dhe menaxhmentit, që janë afër 25%.

6. ALEANCA SHQIPTARE

Aleanca Shqiptare ka 67 kandidatë/e, nga të cilët 46 meshkuj (69%) dhe 21 femra (31%).



Grafiku: struktura gjinore


Moshë mesatare në këtë listë është 37 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70
67	18	29	14	3	3

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Shumica e kandidatëve/eve janë nga Ulqini.

■ Vendbanimi i përhershëm




Grafiku: struktura rajonale

Ndër kandidatët/et e kësaj liste kryesojnë ekonomistët dhe menaxherët, të cilët zënë mbi 25%.

7. Kthesa për Malin e Zi të sigurt – Srgjan Periq

Lista Kthesa ka 54 kandidatë/e, nga të cilët 37 janë meshkuj (69%) dhe 17 janë femra (31%).




Grafiku: struktura gjinore

Moshë mesatare e kandidatëve/eve në këtë listë është 41 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80
54	12	16	9	10	6	1

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Shumica e kandidatëve/eve në listë janë nga Podgorica.




Grafiku: struktura rajonale

Numri më i madh i kandidatëve/eve të Kthesës vijnë nga fusha e teknologjisë dhe inxhinierisë, të cilët janë afër një të katërtën.

8. Lëvizja për Ndryshime – SË PARI MALI I ZI – Nebojsa Medojeviq – Reformat për shpëtimin e vendit

Lëvizja për Ndryshim ka 81 kandidatë/e, prej të cilëve 51 meshkuj (63%) dhe 30 femra (37%).




Grafiku: struktura gjinore

Moshë mesatare e kandidatëve/eve është 44 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80
81	16	21	13	18	11	2

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Shumica e kandidatëve/eve janë nga Podgorica.




Grafiku: struktura rajonale

Në mesin e kandidatëve/eve në këtë listë janë më së shumti nga sfera e ekonomisë dhe menaxhmentit, d.m.th. pak më pak se një e pesta.

9. PO. NE MUNDEMI PËR MALIN E ZI QYTETAR!

Kjo listë ka 77 kandidatë/e, mes tyre 32 meshkuj (42%) dhe 45 femra (58%), gjë që e bën të vetmen listë ku gratë kanë shumicën.




Grafiku: struktura gjinore

Struktura mesatare e moshës është 42 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	< 20	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80
77	2	13	17	19	16	9	1

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Numri më i madh i kandidatëve është nga Podgorica.




Grafiku: struktura rajonale

Kandidatët/et në këtë listë vijnë kryesisht nga sektori i biznesit, pra afër një e pesta e tyre.

10. BASHKË! Për të ardhmën që të takon – Danijel Zhivković (PDS, SD, UDSH, PL)

Lista ka 81 kandidatë/e, nga të cilët 49 janë meshkuj (60%) dhe 32 janë femra (40%).




Grafiku: struktura gjinore

Në pjesën e strukturës moshore mesatarja është 39 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70
81	16	29	25	10	1

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Edhe pse lista mbulon shumicën e komunave malazeze, numrimë i madh i kandidatëve/eve është nga Podgorica.




Grafiku: struktura rajonale

Në strukturën profesionale, mbi një e pesta e kandidatëve/eve në këtë listë vijnë nga sfera e ekonomisë dhe menaxhimit.

11. EVROPA TANI – MILOJKO SPAJIQ

Lista Evropa tani ka 81 kandidatë/e, mes të cilëve 53 meshkuj (65%) dhe 28 femra (35%).




Grafiku: struktura gjinore

Mesatarisht, kandidatët/et janë 39 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80
81	12	39	18	7	4	1

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Deri tani numri më i madh i kandidatëve/eve në këtë listë është nga Podgorica.




Grafiku: struktura rajonale

Në listën e Lëvizjes Evropë tani ka kandidatë/e nga sfera e arsimit dhe shkencës, pak më pak se një e pesta.

12. PDS – PËR SHTËPINË TONË

Lista zgjedhore e PSD-së ka 81 kandidatë/e, prej të cilëve 55 janë meshkuj (68%) dhe 26 femra (32%).




Grafiku: struktura gjinore

Moshë mesatare e kandidatëve/eve është 42 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	< 20	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80
81	1	18	21	15	15	10	1

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Edhe pse ka kandidatë/et nga një numër i madh komunash, shumica e tyre janë nga Podgorica.




Grafiku: struktura rajonale

Në strukturën profesionale më të përfaqësuarit janë kandidatët nga fusha e ekonomisë dhe menaxhmentit, të cilët janë rreth 17%.

13. ALEKSA DHE DRITANI – GUXIMI vlerësohet!

Lista ka 81 kandidatë/e, nga të cilët 56 janë meshkuj (69%) dhe 25 janë femra (31%).




Grafiku: struktura gjinore

Mesatarisht, kandidatët/et janë 41 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80
81	10	38	13	14	4	2

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Kjo listë ka kandidatë/e pothuajse nga të gjitha komunit, por numri më i madh është nga Podgorica.




Grafiku: struktura rajonale

Numri më i madh i kandidatëve/eve në këtë listë vjen nga sfera e ekonomisë dhe menaxhmentit, mbi një e katërta.

14. PËR TË ARDHMEN E MALIT TË ZI (Demokracia e Re Serbe, Partia Popullore e Mali të Zi, Partia e Punës)

Lista ka 81 kandidatë/e, nga të cilët 55 janë meshkujt (68%) dhe 26 janë femrat (32%).




Grafiku: struktura gjinore

Mosha mesatare e kandidatëve/eve është 42 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70
81	13	27	16	19	6

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Me pjesëmarrjen e kandidatëve/eve nga komuna të ndryshme, numri më i madh është nga Podgorica.




Grafiku: struktura rajonale

Në listën e këtij koalicioni kryesojnë kandidatët/et nga fusha e arsimit dhe shkencës, më shumë se një e pesta.

15. Forumi shqiptar – Nik Gjelloshaj "BESA për Zhvillim Evropian

Kjo listë ka 60 kandidatë/e, nga të cilët 42 janë burra (70%) dhe 18 janë gra (30%).




Grafiku: struktura gjinore

Moshë mesatare e kandidatëve/eve është 37 vjeç.

Numri i kandidatëve/eve	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80
60	20	22	9	4	4	1

Tabela: raporti i strukturës së moshës

Lista ka kandidatë/e nga gjashtë komuna, shumica kryesisht vijnë nga Tuzi.



Grafiku: struktura rajonale

Lista ka më së shumti kandidatë/e nga fusha e arsimit dhe shkencës, saktësisht një e katërta e tyre.

